



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.41, datë 26.12.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES TË OBJEKTIT:  
“GODINË BANIMI, SHËRBIMI DHE HOTELERI 1-4 DHE 8-16 KATE DHE ME 4 KATE  
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “DRITAN HOXHA””, BASHKIA  
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Nova Construction 2012” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit: “Godinë banimi, shërbimi dhe hoteleri 1-4 dhe 8-16 kate dhe me 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Dritan Hoxha”, Bashkia Tiranë”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.27, datë 27.07.2022 nga shoqëritë “Nova Construction 2012” sh.p.k dhe “LTD Co” sh.p.k, në shoqërinë “Nova Construction 2012” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINIËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29 / 12 / 2023